

## Në botë thellohet interesimi për kulturën shqiptare

*Doktor Robert Elsi nga Kanadaja tash 14 vjet jeton në Evropë. Është njëri nga pjesëmarrësit e Seminarit XIV Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. Është autor i tre librave nga letërsia shqip, të përkthyer dhe të botuar në gjuhën angleze dhe në atë gjermane. Për interesimet e tij për kulturën, gjuhën dhe letërsinë shqiptare, për Seminarin dhe për disa çështje të tjera zhvilluam këtë bisedë.*

[ShV]: Kur dhe si filluan interesimet tuaja për gjuhën, kulturën dhe letërsinë shqiptare?

[RE]: Pak kam ditur për gjuhën, kulturën dhe letërsinë shqipe. Në Bon në vitin 1979 më lindi dëshira të merrem me këto çështje. Qysh më herët kam pasur interesim të merrem me një popull të vogël të Evropës. Së pari kam mësuar nga fjalorët, e pas 4 vjetësh studimi të problemeve nga gjuhësia fillova të vij në seminarin ndërkombëtar që mbahet në Prishtinë.

[ShV]: Çka keni ditur para vitit 1978 për kulturën shqiptare?

[RE]: Pak. Pak ka përkthime për të huajt që të mund të merren me këtë kulturë. Të interesuarit nga bota e jashtme nuk kanë çka të lexojnë. Ky qe edhe qëllimi im: të përkthej nga gjuha shqipe në gjuhën gjermane dhe në atë angleze. Mendoj se ashtu mund të informohet opinioni i huaj për këtë kulturë. Më parë interesimi i shtëpive botuese për botimin e veprave të përkthyer nga gjuha shqipe ka qenë i kufizuar, por këto dy vjetët e fundit në Gjermani është shtuar interesimi. Shpresoj se edhe në Amerikë, sado që më ngadalë, do të fillojë interesimi për albanologjinë.

[ShV]: Si u lindi ideja të merreni me gjuhën dhe letërsinë shqipe?

[RE]: Shqiptarët dhe kultura e tyre janë paksa të fshehura për opinionin ndërkombëtar, e dihet se ata janë ndër popujt më të lashtë të Evropës. Nuk është vetëm kjo, sepse ata janë evropianë dhe se të tillë ka çka të mësohet dhe çka t'u tregohet të huajve nga kultura e tyre. Shpresoj edhe pse kjo është punë e mundimshme dhe e vështirë, se do t'ia dal deri diku të përmbush një zbrazëtirë që popujt e tjerë të njihen me këtë gjuhë e kulturë.

[ShV]: Deri tash keni përgatitur, përkthyer e botuar “Leksikonin e letërsisë shqipe” (anglisht në vitin 1986), mandej keni përkthyer “Vargjet e lira” të Migjenit (gjermanisht) dhe para pak kohe doli libri juaj i tretë që ka të bëjë me këtë letërsi, antologjia e poezisë shqipe nga shekullit XVI deri me sot me titull “Si një shqiponjë.” A mund të na thoni se cilat janë vështirësitë që has një i huaj në gjetjen e materialit gjatë përkthimit dhe botimit të këtyre librave?

[RE]: Vështirësi ka. Gjuha poetike është tjetër nga ajo e prozës. Dihet se mungon fjalori poetik për gjuhën shqipe, mandej ka disa poetë që kanë shkruar në dialektin e caktuar e dihet se shumë prej atyre fjalëve nuk janë në fjalorët e sotëm. Edhe sigurimi i veprave

nuk është punë e lehtë. T'ju tregoj se vitin e kaluar, kur isha në seminar, e parapagova "Mesharin" e Buzukut dhe revistën "Fjala." Meshari më erdhi vetëm para disa muajsh, ndërsa revista "Fjala" më ka ardhur vetëm tre numra, e prej tyre dy numra të njëjtë. E kam shkruar edhe Rilindjes por as kjo nuk më ka ndihmuar. Edhe shtëpitë botuese e kanë të vështirë të përkthejnë dhe të botojnë libra nga gjuha shqipe, edhe pse tash puna ka ndryshuar.

[ShV]: Për lexuesit tanë do të ishte interesante të tregoni sa fiton përkthyesi në Gjermani?

[RE]: Unë nuk përkthej letërsi për të holla. Për ekzistencë përkthej materiale të tjera. Antologjine e botuar së fundi e ka financuar Instituti Shtetëror i Gjermanisë për Marrëdhënie me Botën e Jashtme. Mund t'ju them se unë për punë e bërë nuk kam marrë asnjë markë. Libri është botuar në tirazh prej një mijë ekzemplarësh dhe një ekzemplar kushton 25 marka gjermanoperëndimore. Kam qenë i interesuar që Migjeni të botohet paralelisht në gjuhën shqipe dhe gjermane në një libër. Për këtë u shkrova lëter shokëve të Rilindjes, por përgjigje nuk mora.

[ShV]: Jeni ndër ata që merren njëkohësisht me gjuhësi dhe me letërsi. A mund të na thoni se cili është raporti mes gjuhësisë dhe letërsisë dhe si i shihni ju këto dy fusha?

[RE]: Në rrethet universitare të vendeve perëndimore prin interesimi për gjuhësinë shqiptare, e së voni është shtuar interesimi edhe për letërsinë, pok kjo nuk ka të bëjë vetëm me atë shqiptare. Kështu ndodh edhe me kulturat e tjera.

[ShV]: Çka mund të na thoni për kontaktet e të huajve midis tyre dhe për kontributin e tyre në këtë fushë?

[RE]: Kontaktet janë shumë të dobishme, edhe kontributi i tyre nuk është i vogël. Të njihesh me një kulturë dhe të mundohesh që të njëjtën t'ua bësh të afërt edhe të tjerëve është punë që sjell kënaqësi.

[ShV]: Jeni duke vijuar Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. A mendoni se duhet ndërruar diç në mënyrën e tanishme të punës së këtij seminari?

[RE]: Nga ky seminar përfitojmë shumë. Kontaktet me albanologët e huaj, me profesorët e Fakultetit Filozofik, me shkrimtarët, me intelektualët dhe me popullin janë shumë të dobishme. Prej tyre njihemi me elementet dhe të arriturat më të reja në lëmenj të ndryshëm. Mësimi mund të organizohet edhe më mirë. Janë disa çështje organizative që duhen ndryshuar. Kështu, fjala vjen, ka disa seminaristë që kanë mësuar disa fjalë në gjuhën shqipe e ka edhe të tillë që nuk dinë asnjë fjalë, e ata janë bashkë në një kurs, në kursin e parë. Mendoj se fillestarët nuk duhet të kenë vetëm një kurs, por duhet ndarë në fillestarë absolutë dhe në ata që dinë diç.

[ShV]: Si autor i antologjise së lirikës shqipe, a mund të na shfaqni mendimin tuaj kritik për këtë lloj të krijimtarisë?

[RE]: Lirika shqiptare për nga niveli i saj artistik pak dallohet nga lirkat e tjera që shkruhen në Evropë. Mendoj se me vlerat e saj ajo nuk ngel prapa lirikës evropiane, por në lirikën shqipe vërehet edhe një ndikim pozitiv nga letërsia popullore.

[ShV]: Si e shpjegoni ju të dhënë që populli shqiptar, edhe pse, siç thoni vetë, ndër popujt më të lashtë evropianë, traditën e shkrimit e ka të vonë?

[RE]: Populli shqiptar është një popull i vogël, me traditë të lashtë. Rrethanat kanë ndikuar që tradita e shkrimit të mos jetë më e vjetër, por kjo nuk ngjet vetëm me gjuhën shqipe. Lituanishtja, p.sh. është gjuhë shumë e vjetër në Evropë, por edhe ajo fillon të shkruhet kur edhe gjuha shqipe.

[ShV]: Në mesin tonë pak dihet për jetën dhe për problemet e brezit të ri në Gjermani. Cili do të ishte vlerësimi juaj për këto çështje?

[RE]: Brezi i ri në Gjermani ka problemet e veta. Problemi ekonomik i papunësisë edhe atje është i pranishëm edhe pse jo në të njëjtën masë sikur te ju. Për dallim prej disa mjediseve të tjera, brezi i ri gjerman lexon mjaft. Të rinjtë gjermanë lexojnë prozë më shumë (sa kam arritur të shoh, këtu me shumë lexohet poezia) dhe atë prozën bashkëkohore botërore. E kanë atë mundësi. Lexojnë në gjuhën gjermane, por edhe në atë angleze. E dihet se veprat më të reja dhe më të mira për një kohë të shkurtër depërtojnë në tregun gjerman.

[ShV]: A kontaktoni me punonjësit tanë përkohësisht të punësuar në Gjermani?

[RE]: Ata që punojnë në Gjermani nuk janë intelektualë. Ata i kryejnë punët që nuk i bëjnë gjermanët. Me ta bisedoj me gëzim në gjuhën shqipe. Janë mikpritës dhe i gëzohen mikut.

[ShV]: Cila do të ishte porosia e albanologut dhe e poliglotit Robert Elsi për gjuhën dhe letërsinë në përgjithësi dhe për atë shqipe në veçanti?

[RE]: Është e ditur se gjuha, kultura dhe letërsia janë elemente që i afrojnë popujt e ndryshëm të botës. Përmes përkthimeve nga gjuha shqipe mendoj se këtë letërsi ta afirmoj në botë edhe pse e di se kjo është një punë jashtëzakonisht e vështirë dhe me përgjegjësi. Posaçërisht i vështirë është, siç dihet, përkthimi i poezisë nga një gjuhë në tjetrën. Në parathënien e antologjisë sime të poezisë shqipe unë kam cituar mendimin e një poeti se “ta lexosh poezinë në përkthim është njësojë si ta përqafosh nusen me vello.” Ndoshta kjo do të ishte një lloj arsytimi edhe për lëshimet eventuale të përkthimeve të mia. Do të përpiqem që këtë punë ta vazhdoj dhe ta përsos në të ardhmen.

Bisedoi: Shpend Vinca.

[botuar në / published in: *Zëri i Rinisë*, Prishtina, 3 shtator/September 1988.]